

VENDIM
Nr. 476, datë 1.8.2023

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 704, DATË 4.11.2022, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR PJESËMARRJEN E PERSONELIT TË FORCAVE TË
ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË OPERACIONIN E
PREZENCËS DHE VIGJILENCËS SË PËRFORCUAR (EVA), DREJTUAR NGA
NATO-ja, NË BULLGARI”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në shkronjën “a”, të pikës 5, të vendimit nr. 704, datë 4.11.2022, të Këshillit të Ministrave, togfjalëshi “... 6 000 (gjashtë mijë) lekë ...” zëvendësohet me “... 8 000 (tetë mijë) lekë ...”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.

3. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama